



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



NJOFTIM

PËR ORARIN E TAKIMEVE TË KOMISIONEVE KËSHILLUESE TË KONSUMATORËVE

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është autoritet i pavarur rregullator në pajtim me nenin 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Kosovës, që ka autoritet dhe përgjegjësi ligjore të rregullojë aktivitetet e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe shërbimet e mbeturinave.

Një ndër funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të ZRRUM është edhe **mbrojtja e interesave të konsumatorëve** duke u përkujdesur që shërbimet që atyre iu ofrohen nga ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe mbeturinave të jenë në nivelin e standardeve të përcaktuara. Rrjedhimisht, ZRRUM angazhohet që konsumatorët të kenë në dispozicion mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre.

ZRRUM në konsultim me Kuvendet Komunale ka themeluar Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve në 7 regjione të Kosovës, roli i të cilëve është të shqyrtojnë dhe ti zgjidhin ankesat e konsumatorëve në lidhje me shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave.

Me qëllim të krijimit të kushteve për participim aktiv të konsumatorëve në çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet publike të ujësjellësit dhe mbeturinave, **ZRRUM ju fton të merrni pjesë në takimet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) të cilat mbahen në baza mujore dhe janë të hapura për publikun.**

Orari i takimeve të KKK-ve për muajin shkurt 2011

Komisioni Këshillues i Konsumatorëve	Data e Takimit	Koha e Takimit	Vendi i Takimit
Regjioni i Prizrenit	21 shkurt 2011	11:00	Salla e Kuvendit Komunal (te Posta), Prizren
Regjioni i Mitrovicës	22 shkurt 2011	11:00	Salla e Kuvendit Komunal, Mitrovicë
Regjioni i Gjakovës	23 shkurt 2011	11:00	Salla e Kuvendit Komunal, Gjakovë
Regjioni i Pejës	23 shkurt 2011	13:00	Salla e Kuvendit Komunal, Pejë
Regjioni i Ferizajt	24 shkurt 2011	10:00	Salla e K.R.U. "Bifurkacioni " Ferizaj
Regjioni i Gjilanit	24 shkurt 2011	12:00	Salla e vogël e KK "Ish Bankkosi"-Gjilan
Regjioni i Prishtinës	25 shkurt 2011	12:00	Objekti i ZRRUM, Rruga "Ferat Dragaj" 68 (afër "Furra Qerimi"), Prishtinë.